



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
HISTORI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_

VENDI \_\_\_\_\_

KOMUNA \_\_\_\_\_


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: c953e6950239

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

## UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (  ), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR  
TESTI  
HISTORI

1. Si quhet periudha kohore e cila zgjatë një mijë vjet.  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Milenium       Epokë       Shekull       Qindvjetësh

2. Në cilën periudhë kohore miratohet Edikti i Milanos (në vitin 313 para erës sonë)?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- koha e vjetër       mesjeta       koha e re       koha bashkëkohore

3. Çfarë kuptojmë me termin antisemitizëm?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- paragjykimet dhe urrejtja ndaj romëve       paragjykimet dhe urrejtja ndaj hebrenjëve  
 paragjykimet dhe urrejtja ndaj të huajve       paragjykimet dhe urrejtja ndaj gjinisë femërore

4. Si quhet kushtetuta e parë serbe, e cila paraqitet në kohën e sundimit të princit Millosh Obrenoviçit në vitin 1835?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Vidovdanit       Namesnikë       Shën Stefani       Sretenjit

5. Cilës dinasti udheheqëse i takon mbreti Marko, në poezinë epike si Kraleviq?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Obrenoviçëve       Nemanjiçëve       Mernjavçeviçëve       Lazareviçëve





6. Si quhet lidhja e Britanisë së Madhe, Francës dhe Rusisë, e lidhur në fillimin e shekullit XX?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Blloku Qëndror       Antanta       Pakti Trepalësh       Fuqitë e Boshtit

7. Cili është emërtimi i administratës Osmane, në rrethin e të cilës filloi Kryengritja e Parë Serbe më 1804?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Serbia e Vjetër       Kosova dhe Metohia       Banovina e Danubit       Pashallëku i Beogradit

8. Cilat ishin arsyet e ndërrimit të Dinastisë në Serbi, gjatë vitit 1903?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- vrasja e mbretit Aleksandër ( Dinastia e Obrenoviqëve)       humbja e luftërave ballkanike  
 themelimi i Mbretërisë SKS       vrasja e Mihajl Obrenoviqit

9. Lexo tekstin nga burimet historike dhe paraqit për cilën thënje bëhet fjalë.

„Unë ëndërroj... Ëndërroj se një ditë ky populli amerikan do të zgjohet dhe do jetojnë te bashkuar. Për ne kjo është e vërtet dhe e kuptueshme: se të gjithë njerëzit janë lindur të barabart. Ëndërroj se një ditë ne kodrat e kuqe të Gjeorgjisë fëmijët e robërve të dikurshëm, dhe fëmijët e pronarëve të dikurshëm do ulen së bashku në një tavolin bisedimimi.....

Martin Luter King

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë

- Liria e mësimin fetar       lufta për mbretëri       kundërshtimi racismit       rregullimi ekonomikë

10. Me cilin vit lidhet ngjarja e njohur si “Ramja e Bastiles”

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 1099       1492       1789       1914





**11.** Cili nga personalitetet e përmendura historike është pjesëmarrës i proceseve politike dhe shoqërore të kohës bashkëkohore?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Xhorxh Vashingtoni     Mihajl Gorbaçovi     Mbretëresha Viktoria     Oto fon Bizmarku

**12.** Në gjysmën e dytë të shek XIX në cilin qytet ndodhej selia e shtetit serb:

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Beograd     Zagreb     Novi Sad     Nish

**13.** Cilat nga termat e cekur në kohën bashkëkohore rrjedhin nga periudha e mesjetës?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- lojrat olimpike     krishterizmi     edukimi universitar     shkenca dhe filozofia

**14.** Çfarë paraqet një ndër pasojat e Luftës së Parë Botërore?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Depërtimi në Frontin e Selanikut     Kalimi i banorëve serb nëpër Shqipëri  
 Kushtututa e parë serbe     Krijimi i shteteve sërbo-kroate-slllovene

**15.** Me kujdes lexo tekstin në të cilin sundusi flet për zgjerimin e shtetit të tij.

„Kam zgjeruar kufijt e gjitha provincave...shkatërroi provincat spanjolle dhe gjermane. Nënshtrori fiset alpike, të cilët jetonin në rrethin prej Adriatikut deri te deti Tiren. Nga ky poshttrim vendosa që një popull mos t'i shkakttoj luftë të padrejtë. Me urdhërin tim....u dërguan dy ushtri në të njëjtën kohë, një në Etiopi, tjetra në Arabi...zgjerova kufijt deri në bregun e Danubit. ”

Për cilin shtet bëhet fjalë?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Greqia e vjetër     Roma e vjetër     Egjipti i vjetër     Fenikia





16. Bazuar në burimet historike përcakto për cilën luftë flet burimi.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

„Me njëzet e një tetor filloi pushkatimi... ashtu me roje të fortë i dërguan në humbje, e cila gjindet te përroi Sushicës, Shumarica dhe strehimoret e topave... Aty mbetën të gjithë, të cilët pritën rend për të shkuar në humbje, dëgjuan ushëtima të mitralozave, pushka mitrolozave dhe pushkave...“

- Lufta serbo – turke       Lufta e Parë Botërore       Lufta e Dytë Botërore       Lufta e Ftohtë

17. Çfarë tregon termi „Zgjidhja përfundimtare“?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Marrëveshjen politike për mbarimin e Luftës së Ftohtë.       Marrëveshjen e fuqive perëndimore për zgjedhjen e statusit të Perandorisë Osmane.
- Kërkesen e Kombeve të bashkuara për eliminimin e varfërisë në Afrikë.       Planin për zhdukjen e popullatës hebre nga ana e nacizmit.

18. Në cilën luftë të kryqëzatave ushtria kryqëtare, e udhëhequr nga mbreti gjermano-romak Fridrih Barbarosa, kaloi përmes territorit të Rashkës, me të cilën sundonte zhupani Stefan Nemanja?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Parë       Dytë       Tretë       Katërt

19. Në cilin vit në kuadër të misionit Apollo 11, astronautët për herë të parë zbritën në Hënë?

Ngjyros rrethin para përgjigjes.

- 1961       1969       1972       1980

20. Me kujdes lexo një pjesë nga burimet historike dhe përgjigju në pyetjet?

„në vjeshtën e vitit 1967 peisazhi para nesh filloi të ndryshojë me të madhe. Gradualisht filloi lirimi zinxhiror i lirisë dhe mendimit kritik.... Në *Orlik* (emri i restorantit) bujshëm u prit viti i ri 1968.... Kur kam mbaruar vitin e tretë (studimet e regjisë së filmit) dhe u ktheva në shtëpi, në Beograd me të madhe u paraqitën trazirat studentore. Fakultetet ishin të okupuara dhe nuk kishte mundësi të hyje pa indeks...“

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- jetëshkrimet       memoaret       kronikat       shkrimet



# FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
**HISTORI**

**FORMULARI I IDENTIFIKIMIT**

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

**NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT**

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_  
VENDI \_\_\_\_\_  
KOMUNA \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

